



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 5 prot.

Kamëz, më 24.1. 2025

V E N D I M
Nr. 5 .Datë 24/1 2025
M B I

“MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI STREHIMIT SOCIAL “PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA” PËR VITIN 2025”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 24.01.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.07 Datë 21.01.2025 në mbështetje të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social”i ndryshuar, neni 73 gërma “d”, Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”, VKM Nr.384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Vendimi Këshillit Bashkiak nr.119 dt.19.12.2024 për “Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2025”, Shkresës me nr. Prot. 11049 dt. 27.12.2024 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.126 datë 19.12.2024 miratimin e sistemit të pikëzimit dhe listës së dokumentave për programin “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara” për vitin 2025; Relacionit Komisionit Strehimit me nr.573 Prot datë 16.01.2025; **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës me 42 familje përfituese nga programi strehimit social **“Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”** për vitin 2025.
 2. Efektet financiare për vlerën totale të projektit 46,063,485 (dyzetë e gjashtë milion e gjashtëdhjetë e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë) Lekë që rrjedhin nga pika 1 *do të përballohen me bashkëfinancim në raportin 50% nga Ministria Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me vlerë 23,031,743 Lekë dhe 50% nga buxheti i Bashkisë Kamëz me vlerë 23,031,743 Lekë.*
 3. Të ngarkojë Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Bashkëlidhur këtij vendimi gjendet lista e familjeve përfituese
4. Ky vendim, hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

